
DREJTËSIA SOT

Analizë nga DREJTËSIA SOT

Një reflektim mbi trajtimin institucional të rastit 'Pronto'



DREJTËSIA SOT



Analizë nga DREJTËSIA SOT

Një reflektim mbi trajtimin institucional të rastit ‘Pronto’

Autor: Leutrim Himaj*

Janar 2020

Projekti “Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe.

*Monitorues në projektin ““Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë”

Hyrje

Në vazhden e kërkesave të Bashkimit Evropian (BE) për plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave mbetet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo kërkesë i adresohet institucioneve të Republikës së Kosovës (RKS) të cilat janë të thirrura në bazë të kompetencave ligjore për luftimin e këtyre dukurive negative si dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në shoqërinë kosovare korrupsioni paraqitet në forma të ndryshme duke filluar nga keqpërdorimi i detyrës zyrtare, dhënia e ryshfetit dhe marrja e tij, klientelizmi etj. Padyshim këto forma të korrupsionit ndikojnë në jetën e qytetarëve të RKS-së dhe ndërtimin e institucioneve të saja. Ndërsa si formë sekondare e korrupsionit e cila paraqitet në masë të madhe në Kosovë është edhe nepotizmi. Kjo dukuri vie në shprehje kryesisht me punësimin e të afërmeve apo miqve të ngushtë në poste të larta shtetërore, pa marrë parasysh meritat dhe aftësitë e tyre.

Mund të themi se kjo dukuri tashmë është bërë praktikë që secila parti politike që merr pushtetin, të emërojë persona të afërt që janë lojal ndaj politikave partiake në bordet e ndërmarrjeve publike. Emërimi i anëtarëve partiak në bordet e ndërmarrjeve publike në Kosovë është një ndër proceset që vazhdimisht është kritikuar nga shoqëria civile dhe nga faktori ndërkombëtar.

Një rast i tillë, i cili ka shpërfaqur dukurinë në lidhje me punësimet e kundërligjshme në pozita të larta të ndërmarrjeve publike është rasti i analizur nga Drejtësia Sot, i njohur në publik si afëra "Pronto".

Rasti i ashtuquajtur "Pronto", shkaktoi shqetësim të madh në publik për shkak se, për herë të parë në RKS, përmes mediave janë zbuluar dhe publikuar veprimet dhe metodat e punësimit të disa individëve nëpër pozita shtetërore, nga ndërhyrjet partiake të funksionarëve të lartë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Njëkohësisht zyrtarët e lartë të kësaj partie si ish-kryetari i saj dhe në të njëjtën kohë Kryeministri i atëhershëm i RKS-së Hashim Thaçi, kryetari i tanishëm i PDK-së Kadri Veseli dhe personat tjerë me përgjegjësi në këtë parti ishin të përfshirë në këtë aferë. Prandaj, meqenëse pjesëmarrës në përgjimet e publikuar në media, kanë qenë edhe Presidenti aktual Hashim Thaçi dhe ish- Kryeparlamentari Kadri Veseli, fakt ky që është indikacion i mjaftueshëm që edhe nga të njëjtit të kërkohet llogari dhe përgjegjësi nga prokuroria, gjë që nuk ka ndodhur, bën që forma e trajtimit institucional të këtij rasti të konsiderohet e dobët dhe dështim i sistemit prokurorial në ndjekjen e krimit dhe korrupsionit në vend.

Për më tepër Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), të njëjtit as nuk i ka ftuar as në cilësi të dëshmitarit në procedurë penale ndaj të akuzuarve të tjerë të rastit. Këto dy veprime fillestare të prokurorisë që konsiderohen edhe si veprime kryesore në zbardhjen e rastit, cilësohen si indikacione të mjaftueshme për të vlerësuar që ky institucion që në hapat e parë të zhvillimit të kësaj procedure ka dështuar substancialisht në trajtimin e saj. Rrjedhimisht edhe vendimi lirues për të akuzuarit e tjerë të rastit, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka dështuar në vënien e drejtësisë në rastit konkret meqenëse PSRK ka dështuar në ndërtimin dhe përfaqësimin e interesit të shtetit pranë kësaj gjykate.

Andaj me qëllim të analizimit të mënyrës së trajtimit të kësaj çështje penale nga PSRK dhe Gjykata Themelore Prishtinë në këtë analizë do të trajtohet aktakuza dhe procedura gjyqësore deri në marrjen e aktgjykimit lirues. Kjo me qëllim të identifikimit të shkeljeve dhe gabimeve procedurale dhe profesionale të shkaktuara nga institucionet në fjalë të cilat dërguan në përfundimin e rastit me aktgjykim lirues.

Aktakuza- PPS.nr.45/2016

Prokuroria e EULEX-it me aktvendimin për fillimin e hetimeve, PPS.nr. 82/12, të datës 03 gusht 2012, ka zhvilluar hetime kundër Adem Grabovcit për veprat penale: “Pastrim i parave” nga neni 10 par. 2 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/02, “Lidhja e kontratës së dëmshme” nga neni 237 par.1 dhe 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK), “Krim i organizuar” nga neni 274 par.3 të KPK-së, “Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit” nga neni 339 par.1 dhe 3 të KPK-së, “Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare” nga neni 340 par.1 dhe 3 të KPK-së, “Mashttrim në detyrë nga neni 341 par.1 dhe 3 të KPK-së dhe “Marrja e rryshfetit” nga neni 343 par. 2 të KPK-së. Ky hetim është zhvilluar për periudhën kohore 2008-2010 gjatë kohës sa i njejtë ishte Zëvendës ministër në Ministrinë e Transportit dhe Post telekomunikacionit, në lidhje me tenderin me numër 009/004/511- Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e Rrugëve rajonale, të rajonit të Gjilanit, për vitin 2009/2010.

Me Aktvendimin PSS 104/12, të datës 18 qeshor 2014, prokurori i EULEX-it në pajtim me nenin 158 par.1 (1.1 dhe 1.6) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ka pushuar hetimin kundër Adem Grabovcit për veprat penale të lartëcekura.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës bazuar në hetimin paraprak dhe me publikimin e disa përgjimeve në gazetën online “Insajderi”, me datë 05 gusht 2016, të cilat në opinionin publik u njohën si afera “Pronto”, ka marrë Aktvendim për fillim të hetimeve ndaj Adem Grabovcit¹, në drejtim të veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 193 par. 4 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK). Sipas PSRK, përgjimet kanë rezultuar me faktin se i dyshuari Adem Grabovci ka kontaktuar me një numër të caktuar të personave zyrtar lidhur me punësimin kundërligjor të disa personave të caktuar në institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe përzgjedhjen e tyre në pozitën e drejtorëve të Bordeve të ndërmarrjeve publike, pasiqë Qeveria e RKS-së me datë 31 tetor 2011 ka shpallur konkurs për drejtorët e Bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore. Rrjedhimisht, pas zhvillimit të hetimeve për rastin konkret, PSRK ka ngritur aktakuzë për aferën “Pronto”, me datë 06.04.2018, në drejtim të veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 193 par. 4 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Të akuzuar në këtë rast janë ish-deputeti dhe shefi i grupit parlamentar të PDK-së Adem Grabovci, ish-ministri i inovacionit Besim Beqaj, ish-deputeti Zenun Pajaziti, dy ish-sekretarë të përgjithshëm, Ilhami Gashi dhe Xhavit Dakaj, ish-zëvendësministri Fatmir Shurdhaj, këshilltari politik në Ministrinë e Punëve të Brendëshme (MPB) Sadat Gashi, ish-drejtori i Bordit të Ndërmarrjes Publike “Radoniqi-Dukagjini” në Gjakovë Ismet Neziraj, ish-drejtori i Bordit të Ndërmarrjes Publike “Hidro-Drini” në Pejë Rexhë Abazi, ish-kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit Nijazi Kryeziu dhe ish-shefja e Njesisë për Furnizim në Ministrinë e Shëndetësisë, Arbenita Pajaziti. Ndërsa, Hashim Thaçi si Kryeministër i atëhershëm i Kosovës dhe Kadri Veseli si kryetar i tanishëm i PDK-së, të dy pjesë e bisedave të publikuara, nuk ishin pjesë e aktakuzës së ngritur as në cilësinë e të pandehurve dhe as në cilësinë e dëshimtarëve të rastit.

Sipas aktakuzës, të pandehurit akuzoheshin që kanë keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare duke bashkëpunuar në mes vete për dhënien e privilegjeve dhe përparësive të kundërligjshme personave të cilët kanë konkuruar në funksione të rëndësishme, siç janë: drejtor për Ndërmarrjet publike qendrore, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit në MPB, Kryeshef i Agjencisë për produkte

¹ Aktakuza PPS.nr.45/2016 e datës 06.04.2018, paragrafi i parë i arsytimit, faqe 14.

medicinale dhe Koordinator i Qendrës së Regjistrimit Civil në Komunën e Klinës, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj. Rrjedhimisht, aktakuza akuzon të pandehurit që përmes veprimeve inkriminuese të tyre të përshkruara në aktakuzë, të njejtit kanë tentuar krijimin e privilegjeve apo përparësive për disa persona të caktuar mbi bazën e raportit të tyre të afërt personal dhe përkatësisë politike si dhe kanë diskriminuar- mohuar të drejtat e personave tjerë që kanë konkuruar për pozitën e përcaktuar në konkurset e lartëcekura. Pra, me anë të kësaj aktakuze PSRK ka tentuar të provojë kryerjen e veprës penale të ushtrimit të ndikimit politik të të pandehurve duke vepruar nga prapaskena dhe jo kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit të tyre zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, fakt ky që ka minimizuar dëmin e shkaktuar që dyshohet të jetë kryer nga të gjithë të pandehurit dhe të tjerët. Ky veprim numërohet si dështimi i tretë i PSRK-së në trajtimin dhe mënyrën e aplikuar për zbardhjen e këtij rasti dhe ndëshkimin e krimit që dyshohet të jetë kryer.

Rrjedha e procesit gjyqësor

Kjo çështje penale fillimisht është gjykuar nga trupi gjykues në përbërje të gjyqtarit Shashivar Hoti kryetar, Beqir Kalludra dhe Shadije Gërguri anëtare, mirëpo me avancimin e kësaj të fundit në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në vend të saj si anëtar i trupit gjykues është caktuar herë pas here gjyqtari Lutfi Shala.

Në fjalën hyrëse Prokurorja Speciale Drita Hajdari, të dhënë me datë 26 Qershor, ka deklaruar për dukurinë e punësimeve politike dhe degradimin e shtetndërtimit të RKS-së. Poashtu ajo ka shtuar se të pandehurit e aferës “Pronto” duke vepruar nga prapaskena kanë ndikuar në punësimin e personave të afërt me PDK në institucione të ndryshme si anëtarë bordesh, drejtorë ndërmarrjesh e agjencish të pavarura, por nuk ka elaboruar provat me anë të të cilave do e mbështetë aktakuzën e saj.² Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), në nenin 328 parashesh se në fjalën hyrëse palët përmbledhin provat që mbështesin rastin apo kërkesën e atij që paraqet fjalën hyrëse.³ Me fjalë tjera, palët mund të theksojnë se cilat fakte vendimtare synojnë t’i provojnë, t’i vënë në dukje provat që do t’i procedojnë, çështjet juridike të cilat do t’i shqyrtojnë, etj. Andaj duke marrë parasysh dispozitat ligjore, prokurorja speciale është dashur që të elaborojë provat me anë të të cilave do t’a mbështesë aktakuzën e saj, e jo të mbajë fjalime politike gjatë dhënies së fjalës hyrëse.

Së dyti, në seancën e radhës të mbajtur me 06 shtator 2019, kryetari i trupit gjykues Shashivar Hoti i ka konsideruar të lexuara të gjitha provat e propozuara nga prokuroria në aktakuzën e këtij rasti.⁴ Kja ka ndodhur me arsyetimin e racionalizimit të kohës meqenëse i njejtë ka konsideruar se shumica e provave janë përgjimet e bisedave në mes të pandehurve dhe marrin kohë për t’u ndëgjuar. Ky veprim padyshim vë një pikëpyetje të madhe procedurën e administrimit të provave materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi që sipas dispozitave të KPPRK-së provat materiale duhet të shqyrtohen dhe verifikohen një nga një dhe pas shqyrtimit dhe verifikimit të ju jepet

² Prokuroria nuk propozon asnjë dëshmitar në rastin “Pronto”, Drejtësia Sot, 2019, (shih linkun: <http://www.rolpik.org/prokuroria-nuk-propozon-asnje-deshmitare-ne-rastin-pronto/>).

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, miratuar më 13.12.2012 dhe hyrë në fuqi më 01.01.2013, Neni 328, burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

⁴ Gjykata nuk lejon dëgjimin e përgjimeve në rastin “Pronto”, Drejtësia Sot, 2019, (Shih linkun: <http://www.rolpik.org/gjykata-nuk-lejon-degjimin-e-pergjimeve-ne-rastin-pronto/>).

mundësia palëve që të kundërshtojnë ato në mënyrë të drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit gjyqësor.⁵ Kjo pasiqë shqyrtimi dhe verifikimi i provës në shqyrtim gjyqësor mundëson zbatimin e parimit kontradiktor dhe të barazisë së armëve, parimit të drejtpërdrejtë dhe të publicitetit etj. të cilët, me praninë e tyre, krijojnë një ambient të përshtatshëm për analizë të gjithmbarshme dhe vlerësim të drejtë e të saktë të provave.

Rrjedhimisht, pas përfundimit të procedurës për administrimin e provave dhe fjalës përfundimtare, Gjykata Themelore në Prishtinë, ka shpallur aktgjykim lirues duke u thirrur në mungesë të provave bazuar në nenin 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3. Sipas këtij neni Gjykata para se të marrë aktgjykim lirues sipas nënparagrafit 3 të këtij neni duhet t'i analizojë dhe t'i vlerësoj të gjitha provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor përkitazi me çështjen penale konkrete. Me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues sipas këtij nënparagrafi, çështja e ekzistimit të veprës penale nuk është kontestuese. Vepra penale ekziston, por nuk ka prova të mjaftueshme se i akuzuari e ka kryer atë. Thënë ndryshe, sipas vlerësimit të gjykatës për rastin konkret, vepra penale është konsumuar mirëpo PSRK ka dështuar në dëshmimin e fajësisë së të pandehurve që janë akuzuar me aktakuzën e ngritur, vendim ky që edhe njëherë njeh dështimin e PSRK-së në trajtimin dhe përfaqësimin e kësaj aktakuzë pranë gjykatës.

Shkeljet dhe parregullsitë procedurale të evidentuara nga Drejtësia Sot

Si çdo rast tjetër i korrupsionit dhe krimi të organizuar, i cili është trajtuar me shkelje të madhe ligjore dhe procedurale, edhe rasti konkret karakterizohet me shkelje të shumta nga ana e institucioneve që janë të thirrura të veprojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Fillimisht do të ndalemi tek trajtimi jo adekuat i këtij rasi nga PSRK, duke u nisur nga mospërfshirja e dy personave që mbajnë pozita të larta shtetërore e politike, mungesa e përcaktimit të palës së dëmtuar, mos propozimi i dëshmitarëve për t'u dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, paraqitja e fjalës hyrëse në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe mospërfaqësimin profesional i aktakuzës pranë Gjykatës.

Së pari, aktakuza është e mangët në aspektin subjektiv, pasiqë në të nuk janë përfshirë Kryeministri i atëhershëm dhe tash Presidenti aktual i RKS-së Hashimi Thaçi dhe ish-Kryeparlamentari Kadri Veseli, edhe pse të njejtë janë pjesë e përgjimeve të publikuara njejtë si të akuzuarit e tjerë të këtij rasti. Por PSRK, pjesën e përgjimeve ku dëgjohej këta dy persona e ka konsideruar si irelevante dhe për këtë institucion, këto pjesë të përgjimeve nuk kanë paraqitur bazë të mjaftueshme për të filluar hetimet ndaj tyre.

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike zgjidhen dhe emërohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga kjo rrjedhimisht del se Kryeministri i Republikës së Kosovës në këtë rast Hashim Thaçi, ka qenë në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni për çfardo formë apo tentim të zgjedhjes së këtyre anëtarëve të bordeve në mënyrë të kundërligjshme.⁶ Ndërsa Kadri Veseli, ish-Kryeparlamentar në mandatin e kaluar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dyshohet të ketë shpërfaqur ndikimin e tij në strukturat e PDK-së dhe në anëtarët e Qeverisë për të vendosur në lidhje me emërimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.

⁵ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, miratuar më 13.12.2012 dhe hyrë në fuqi më 01.01.2013, Neni 8 par. 2: "Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor".

⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, i datës 15.06.2008, (burimi: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>).

Së dyti, në këtë rast nuk është përcaktuar pala e dëmtuar, nga pretendimi i prokurorisë për kryerjen e kësaj veprë penale. Kjo për faktin se për t'u përmbushur elementet e veprës penale "Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës" nga neni 193 i KPRK-së, duhet të ekzistojë edhe pala e dëmtuar, poashtu duhet të vërtetohet se cilëve persona i është mohuar një e drejtë apo i është dhënë një privilegj për shkak të një përkatësie politike. Mos identifikimi i palës së dëmtuar paraqitet një ndër mangësitë esenciale të kësaj aktakuze, pasi që në të nuk është përcaktuar me saktësi se kush është palë e dëmtuar për secilën pikë të akuzës.

Sipas obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e KPRK-së, përkatësisht nenit 124 par.2, prokurori i shtetit duhet ex-officio ta ftojë të dëmtuarin që ta marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit, pasi që i njëjti është dëshmitari okular dhe nga i cili mund të përfitohen njohuritë e detajuara për pretendimet se është kryer vepra penale e caktuar. Gjatë marrjes në pyetje, prokurori duhet që nga i dëmtuari, tani i ftuar në cilësinë e dëshmitarët, të marrë informata rreth vlerës së dëmit që pretendohet të jetë shkaktuar, dhe si rezultat i kësaj në bazë të nenit 136 të KPRK-së duhet të caktojë ekspertë të profilizuar në fushën përkatëse. Andaj Prokuroria nuk ka arritur të bëjë përcaktimin e palës së dëmtuar në këtë çështje penale dhe kjo tregon mospërgatitjen profesionale dhe mungesën e efikasitetit të prokurorisë në vërtetimin e kryerjes së veprës penale së lartcekur.

Së treti, rol të rëndësishëm dhe padyshim thelbësor në procedurën e të provuarit luan edhe dëshmitari. Në rastin konkret PSRK-ja nuk ka propozuar asnjë dëshmitar i cili do të ndriqonte çështjen penale në tërësi. Andaj lidhur me këtë çështje vërehet mungesa e vullnetit të Prokurorisë që të zbardhë rrethanat e plota të pretendimit të kryerjes së veprës penale.⁷

Së katërti, në fjalën hyrëse të Prokurores Speciale Drita Hajdari, kemi hasur në shkelje të KPRK-së, përkatësisht nenin 328 par. 1 dhe 2, pasi që prokurorja nuk ka elaboruar provat me anë të të cilave e mbështetë aktakuzën e saj, por gjithnjë gjatë dhënies së kësaj fjale ka treguar për dukurinë e punësimeve politike dhe ndikimet e klanit "Pronto" në ato punësime. Pos tjerash kjo tregon mos përgatitjen profesionale të përfaqësimit të aktakuzës në gjykatë dhe po ashtu dështimin e organit të ndjekjes penale në luftimin e krimit të dyshuar.

Së pesti, mangësi tjetër në lidhje me trajtimin e këtij rasti është paaftësia ligjore dhe profesionale e Prokurores, për të argumentuar me prova të vlefshme dhe ligjore se të akuzuarit e aferës "Pronto", në bashkëkryerje nga neni 31 kanë kryer veprën penale "Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës" në tentativë nga neni 193 par. 4 lidhur me par. 1 dhe neni 28 të KPRK-së. Kjo për arsye se gjatë të gjitha seancave gjyqësore prokurorja ka zhvilluar polemika me kryetarin e trupit gjykues dhe avokatët mbrojtës dhe nuk ka përfaqësuar aktakuzën në mënyrë profesionale duke argumentuar provat dhe faktet relevante. Kjo padyshim vë në pikëpyetje qëllimin e prokurorisë në luftimin e krimit të organizur dhe korrupsionit.

Në anën tjetër, në trajtimin jo të duhur të kësaj procedure penale ka kontribuar edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, veprimet e së cilës janë përcjellur me mangësi të ndryshme. Këto mangësi kanë të bëjnë me shkeljen e afatit ligjor për caktimin e seancave gjyqësore, pastaj gabimet në administrimin e provave materiale, si dhe gjatë shpalljes së aktgjykimit, nuk ka respektuar procedurën e kërkuar sipas dispozitave ligjore lidhur me arsyetimin e aktgjykimit.

Së pari, qysh në caktimin e shqyrtimit fillestar gjykata është vonuar dhe ka caktuar këtë seancë mbas pesë (5) muaj e 24 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Kjo pasi që aktakuza është ngritur me 06

⁷ Prokuroria nuk propozon asnjë dëshmitar në rastin "Pronto", Drejtësia Sot, 2019, (shih linkun: <http://www.rolpik.org/prokuroria-nuk-propozon-asnje-deshmitare-ne-rastin-pronto/>).

prill 2018 kurse shqyrtimi fillestar është caktuar të mbahet me 1 tetor të vitit 2018.⁸ Kjo paraqet shkelje të KPPRK-së ngase neni 242 par.4, i këtij Kodi thotë se: *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”*. Pra në rastin konkret shqyrtimi fillestar është mbajtur pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e KPPRK-së.

Së dyti, Gjykata ka shkelur edhe afatet ligjore për caktimin e seancës së shqyrtimit të dytë, kjo pasiqë shqyrtimi i dytë është mbajtur 4 muaj e 4 ditë nga mbajtja e shqyrtimit fillestar. Shqyrtimi fillestar në këtë rast është mbajtur me datë 1 tetor 2018 kurse shqyrtimi i dytë është mbajtur me 4 shkurt 2019.⁹ Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 245 par.5 të KPPRK-së, pasiqë e njejta dispozitë thotë se: *“Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”*.

Së treti, si shkelje tjetër mund të cekim edhe mos lejimin e dëgjimit të përgjimeve të bisedave të të pandehurve të klanit “Pronto”. Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 8 par.2 të KPPRK-së, sepse e njejta dispozitë thotë se: *“Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor”*. Pra norma juridike e obligon Gjykatën që gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi të shqyrtohen dhe verifikohen provat materiale, të ju jepet mundësia palëve që të kundërshtojnë ato në mënyrë të drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit gjyqësor, e gjitha kjo me qëllim të zbatimit të parimit kontradiktor dhe të barazisë së armëve të palëve në procedurë.

Së katërti, me rastin e shpalljes së aktgjykimit Gjyqtari Shashivar Hoti, nuk e ka arsyetuar marrjen e aktgjykimit lirues për të akuzuarit e aferës “Pronto”, mirëpo vetëm e ka lexuar dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ndërsa, sipas nenit 366 par.2 i KPPK-së, thuhet se: *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në prani të palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë, të përfaqësuesve të autorizuar dhe të mbrojtësve lexon në seancë të hapur dispozitivin dhe shkurtimisht prezenton arsyet e aktgjykimit.”* Andaj në rastin konkret gjyqtari Hoti ka bërë shkelje të dispozitave të lartëcekura pasiqë nuk ka dhënë shkurtimisht arsyet e marrjes së aktgjykimit lirues.

Përfundimi

Gjatë analizës së aktakuzës dhe veprimeve procedurale të ndërmarra nga prokuroria dhe gjykata, vërejmë që ky rast është trajtuar me parregullsi dhe shkelje të shumta ligjore dhe procedurale. Këto mangësi formale dhe procedurale kanë ndodhur për faktin se me veprimet e organeve të drejtësisë nuk janë përmbushur pritshmëritë ligjore për zhvillimin e procedurës penale të këtij rasti në bazë të standardeve profesionale. Kjo argumentohet veçanërisht me veprimet e PSRK-së, duke filluar nga dështimi i ndjekjes penale të duhur dhe të plotë e deri te mungesa e profesionalizmit të përfaqësimit të aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor. Të gjitha elementet e lartëcekura pa mëdyshje tregojnë mungesën e vullnetit dhe guximit të këtij institucioni në kryerjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore kur bie fjala tek ndjekja penale e krerëve të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës.

⁸ Grabovci mungon në seancën e parë për rastin ‘Pronto’, kallxo.com, 01.10.2018, (shih linkun: <https://kallxo.com/shkurt/grabovci-mungon-ne-seancen-e-pare-per-rastin-pronto/>).

⁹ Të akuzuarit dhe avokatët kundërshtojnë akuzat në rastin ‘Pronto’, kallxo.com, 04.02.2019, (shih linkun: <https://kallxo.com/shkurt/te-akuzuarit-dhe-avokatet-kundershtojne-akuzat-ne-rastin-pronto/>).

Argument tjetër i mospërbushjes së obligimeve ligjore është shkelja e afateve të KPPRK-së për caktimin e seancave gjyqësore nga vetë Gjykata Themelore në Prishtinë. Kjo paraqet neglizhencën e gjykatës në kujdesin dhe respektimin e dispozitave ligjore për zhvillimin procedurës penale në mënyrë të suksesshme.

Për fund, faktorët ndërkombëtar vazhdimisht kanë kërkuar nga institucionet e sistemit të drejtësisë rezultate konkrete në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këto rezultate konsistojnë në zhvillimin e procedurave penale konform dispozitave ligjore edhe kundër çdo zyrtari të lartë shtetëror apo figure politike, nëse ekziton dyshimi i bazuar mirë se të njejtit kanë kryer vepra penale të kësaj natyre. Raportet e Bashkimit Evropian si dhe institucioneve tjera ndërkombëtare alarmojnë për nivelin e lartë të korrupsionit në institucionet publike, ndërsa organet tona të drejtësisë tregojnë rezultat të dobët në luftimin e kësaj dukurie. Si rezultat i pandëshkueshmërisë së korrupsionit të lartë, Kosova vazhdon të jetë shtet jofunksional derisa të mungojë vullneti për të luftur këtë dukuri në mënyrë efektive.



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies
